

SUNDIMI I LIGJIT

NË KAPITULLIN 19

POLITIKA SOCIALE DHE PUNËSIMI¹

Punoi: Prof. As. Dr. Eneida Sema

Autor: © Qendra për të Drejtat në Punë, CLR

¹Per punimin e këtij materiali janë përdorur jo vetëm akte ligjore vecanerisht në fushën e marrëdhënieve të punës dhe punësimit, por gjithashtu edhe dokumenta politike, strategji kombëtare, akt plane-veprimi, progress raportet e Komisionit Europian në vlerësimin periodik të përvitshëm për Shqipërinë, dhe analiza statistikore.

Phone

+355 69 402 0057

Address

Rr."Frederik Shiroka" Pallati "Alba", Shk. 4, Ap. 7

Website

www.clr.al

1. PROGRESI NË PROCESIN E NEGOCIMIT NË KAPITULLI 19 - POLITIKA SOCIALE DHE PUNËSIMI

Tashme prej vitesh, Shqiperia synon anetaresimin ne familjen europiane, familje se ciles i perket. Ky process i gjate, ende ne zhvillim, ka nisur me nenshkrimin e Marreveshjes se Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian, marreveshje e cila hyri ne fuqi me 1 Prill te vitit 2009.

Ne kuader te pranimit dhe zbatimit te “Kritereve te Kopenhagenit”, te percaktuara nga Keshilli European ne vitin 1993 ne Kopenhagen, Republika e Shqiperise eshte zotuar te:

- Te ndertoje institucione qe garantojne parimet themelore te nje vendi demokratik, te garantoje te drejtat e njeriut dhe te respektoje te drejtat e minoriteteve ne vend.
- Te krijojte nje ekonomi tregu funksionale per te qene e afte te perballoje forcat e tregut brenda Bashkimit European.
- Te jete e afte te permbushe objektivat politike, ekonomike dhe monetare

Nje kriter i katert u vendos ne Madrid nga Keshilli Evropian:

- Te krijohen strukturat e duhura administrative dhe gjyqesore me qellim zbatimin efektiv te legjislacionit te Bashkimit European.

Pas kerkeses zyrtare te Shqiperise per anetaresim ne Bashkimin European ne vitin 2009, Keshilli European dha statusin e vendit kandidat ne Qershor te vitit 2014.

Nder angazhimet kryesore te Shqiperise pergjate ketij procesi ka qene perafrimi i legjislacionit me kuadrin ligjor te Bashkimit European, dhe zbatimi efektiv i tij. Pas nenshkrimit te Marreveshjes se Stabilizim-Asociimit, u hartua dhe miratua Plani Kombetar per Zbatimin e MSA-se per periudhen 2007-2012, qellimi kryesor i te cilit ishte perafrimi i legjislacionit. Ne vijim te ketij procesi, Plani tjetër Kombetar i perket periudhes 2014-2020 dhe tashme ne zbatim eshte Plani Kombetar i Integritimit European 2021-2023 dhe 2022-2024, pjese integrale e te cilit eshte edhe punesimi dhe te drejtat e parimet themelore te lidhura me te.

Procesi i perafimit me ‘Acquis Communautaire’ dhe zbatimin perbehet nga 35 kapituj, nje nder te cilet, konkretisht Kapitulli 19 i referohet politikave sociale dhe punesimit dhe kryesisht:

- Vendosjen e standarteve minimum ne legjislacionin e punes
- Ceshtjetlidhur me parimin e trajtimittebarabarte ne punesim
- Shendetidhesiguria ne pune
- Ndalimi i diskriminimit
- Zhvillimi i dialogut social ne nivelEuropean
- Punesimi
- Mbrojtjasociale
- Fondi Social European

Vendimi i Keshillit European, i dates 26 mars 2020 per nisjen e negociatave te anetaresimit me Shqiperine i parapriu Konferences Nderqeveritare te zhvilluar ne Bruksel ne Korrik 2022 per hapjen e negociatave dhe nisjen e procesit ‘screening’.

Komisioni European me 19 Tetor 2021, ne Strasbourg prezantoi Paketën e Zgjerimit per vendet e Ballkanit Perendimor, takim pergjate te cilit u prezantua edhe Raporti per Shqiperine duke konsideruar keshtu kriterin politik, arritjet ne reformen lidhur me administraten publike, reformen ne systemin gjyqesor, luften kunder krimit te organizuar dhe korrupsionit, ne zbatimin e te drejtave themelore, lidhur me kriterin ekonomik dhe aftesine e tregut per te konkurruar ne tregun e vendeve te BE-se.

Ne drejtim te tregut te punes dhe punesimit cilesohen masat e ndermarra nga qeveria dhe Banka Qendrore pergjate pandemise dhe pasojave negative te termetit te vitit 2019, masa te cilat ndikuan ne ruajtjen e stabilitetit te pergjithshem ne tregun e punes.

1. SUNDIMI I LIGJIT NE KAPITULLIN 19

1.1 TE DREJTAT THEMELORE NE KAPITULLIN 19

Ne Traktatin e Lisbones, nenshkruar ne Dhjetor 2009 parashikohet ne menyre te shprehur se Bashkimi European themelohet mbi parimet themelore, ne respektim te dinjitetit njerezor, lirise, demokracise, barazise, respektimit te ligjit dhe te drejtave themelore te njeriut, perfshire dhe te drejtat qe i perkasin minoriteteve. Keto vlera mbrohen nga legjislacionet e vendeve anetare te cilat mbeshtesin pluralizmin, ndalimin e diskriminimit, drejtesine dhe barazine midis burrave e grave.

Karta e te Drejtave Themelore ne Bashkimin European, sanksionon parimet dhe te drejttat themelore ne nenet 5, 12, 15 etj.:

- Ndalimi i punes se detyruar (Neni 5)
- Liria e organizimeve (Neni 12)
- E drejta per te zgjedhur profesionin dhe e drejta per punesim (Neni 15)
- Ndalimi i diskriminimit (Neni 21)
- Barazia midis grave e burrave (Neni 23)
- E drejta per te perdorur kontraten kolektive si nje nga mjetet ligjore efikase (Neni 28)
- Ndalimi i punes se femijeve dhe mbrojtja e te rinjve ne pune (Neni 32)
- E drejta e punemarresve per informim dhe konsultim (Neni 27)
- Mbrojtja e punemarresve nga largimet e padrejta nga puna (Neni 30)
- E drejta per kushte te drejta pune dhe sigurimi e mbrojtja e jetes dhe shendetit te punemarresve (Neni 31)
- E drejta e punemarreve per leje dhe pushime ne raste te parashikuara me ligj (Neni 33)
- E drejta per sigurim dhe asistence sociale (Neni 34)

Ne Kartën Sociale Europiane të rishikuar parashikohete drejta për punë, e drejta për kushte të drejta pune, e drejta për kushte pune të sigurta e të shëndetshme, e drejta për pagë të drejtë, e drejta për t'u organizuar, dhe e drejta për të negociuar kolektivisht.²

Kjo Kartë sanksionon të drejta të barabarta për të gjithë punonjësit dhe gjithashtu ofron një mbrojtje të vecantë për kategori të vecantë punonjësish.

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut sanksionon lirinë e tubimit dhe të shoqërimit dhe konkretisht parashikon të drejtën e themelimit të sindikatave dhe pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të të punësuarve. Konventa siguron lirinë e mbrojtjes së interesave profesionale të anëtarëve të sindikatave nga lëvizja sindikaliste, ndërsa shteti duhet të mundësojë organizimin dhe zhvillimin e saj.

Ne aspektin nderkombetar, janë një sere aktesh nderkombetare ku sanksionohen parimet dhe të drejtat themelore, ndër të cilat përmendim: Konventa Nderkombetare « për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor » (Kombet e Bashkuara), Konventa “për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave” (Kombet e Bashkuara), Konventa Nr. 111 (shoqeruar nga Rekomandimi 111) “Per Diskriminimin ne Punesim”, Konventa Nr. 100 (dhe Rekomandimi 90) “Per Shperblim te Barabarte”, Konventa Nr. 118 “Mbi Trajtimin e barabarte te shtetasve e te huajve ne sigurim social”

Nder Konventat e Organizates Nderkombetare e Punes përmendim:

Konventa Nr 155 “Per Sigurine dhe Shendetin ne pune”, dhe Protokolli i saj, viti 2002, Konventa Nr 187 “Per Strukturen e Sistemit te Sigurise dhe Shendetit ne pune”, viti 2006, Konventa Nr 167 “Mbi sigurine dhe shendetin ne Sektorin e Ndertimit”, e cila eshte miratuar ne vitin 1988 dhe ka hyre ne fuqi ne vitin 1991, eshte ratifikuar edhe nga vendi yne, Konventa Nr 176 “Mbi sigurine dhe shendetin ne Miniera”³, eshte miratuar ne vitin 1995 dhe ka hyre ne fuqi ne vitin 1988⁴. Konventa Nr. 182 “Per Eliminimin e Formave me te Keqia te Punes se Femijeve”; Konventa Nr. 138 “Per Caktimin e Moshes Minimale te Punesimit” dhe Rekomandimin Nr 146; Konventa Nr 29, 28 Qershor 1930, Konventa Nr 105 viti 1957 “Per ndalimin e punes se detyruar.

2.2 RISHIKIMI I RREGULLOREVE KOMBËTARE QË GARANTOJNË DHE SIGUROJNË TË DREJTAT THEMELORE

KUSHTETUTA - AKTI THEMELTAR KU SANKSIONOHEN TË DREJTAT DHE LIRITE THEMELORE

Ne Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë sanksionohet *ndalimi i punës së detyruar*⁵ (Neni 26) sipas të cilit askujt nuk mund ti kërkohej të kryejë një punë të detyruar, përveçse në rastet e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, të kryerjes së shërbimit ushtarak, të një shërbimi që rrjedh nga një gjendje lufte, nga një gjendje e jashtëzakonshme ose nga një fatkeqësi natyrore që kërcënon jetën dhe shëndetin e njerezve.

²Ligji Nr.8960, datë 24.10.2002 “ Për ratifikimin e Kartës Sociale Europiane të ndryshuar”

³Shqipëria është një ndër vendet që e ka ratifikuar këtë Konventë

⁴Shih: “Working together to promote a safe and healthy working environment”, International Labour Conference, 106th session, 2017, Box 1.3, fq. 20, visit website www.ilo.org

⁵ QBZ, web: qbz.gov.al, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 26

Kushtetuta garanton të gjitha liritë themelore të njeriut, të drejtat vetjake, të drejtat dhe liritë politike dhe liritë e të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore. Në bazë të saj kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm dhe liria e tubimeve paqesore është e garantuar.⁶

Në kapitullin e katërt të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionohen liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore ku ndër të tjera garantohej *e drejta dhe liria për të punuar punë* të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë me qëllim për të fituar mjetet e jetesës. Liria e zgjedhjes së profesionit dhe e punës e sistemi i kualifikimit është e garantuar. Kushtetuta sanksionon gjithashtu të drjeten e mbrojtjes shoqërore.⁷

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton *te drejten e punësuarve për t'u bashkuar lirisht* në organizata sindikale me qëllim mbrojtjen e interesave të tyre të punës.⁸

Po kështu, në aktin themeltar të shtetit e drejta e të punësuarit për greve lidhur me marrëdhëniet e punës është garantuar.⁹

Në Kushtetute sanksionohet *e drejta e sigurimeve shoqërore* në pleqëri, në rastet e paafetisë sipas një sistemi të përcaktuar me ligj dhe po kështu garantohej e drejta e ndihmes për këdo që mbetet pa punë për shkak të caktuar dhe kur nuk ka mjete të tjera jetese.¹⁰

Fëmijet, të rinjtë, gratë shtatzena dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të vecantë nga shteti në bazë të dispozitave kushtetuese.¹¹ Në bazë të Kushtetutës të gjithë shtetasit gezojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti dhe kushdo ka të drejtën e sigurimit shëndetësor sipas një procedure të përcaktuar me ligj.¹²

Kushtetuta e Shqipërisë në kreun saj për objektivat sociale¹³ garanton *punësimin* në kushtet e përshtatshme të të gjithë personave të aftë për punë, plotësimin e nevojave për strehim, *standartin më të lartë shëndetësor, fizik, mendor, arsimim* dhe kualifikimin sipas aftësive dhe personave të pazënë me punë, garanton *një mjedis të shëndetshëm* dhe ekologjikisht të përshtatshëm për të gjithë brezat, *garanton ndihmën dhe perkujdesjen* për të moshuarët, invalidët dhe jetimet, zhvillimin e sportit dhe veprimtarive ripërtëritëse, riaftësimin shëndetësor, *edukimin e specializuar*, dhe integrimin në shoqëritë të paafetësive edhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë sanksionon dhe garanton të drejtën për arsim, garanton autonomine e institucioneve të arsimit të lartë dhe lirinë akademike.¹⁴

LEGJISLACIONI I PUNES

Kodi i punës është ligji bazë që rregullon parimet dhe të drejtat në punë. Ai bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, respekton konventat ndërkombëtare dhe është i bazuar

⁶ QBZ, web: qbz.gov.al, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 46, 47

⁷ QBZ, web: qbz.gov.al, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 49, Kreu IV "Liritedhetedrejtatekonomike, sociale dhe kulturore"

⁸ QBZ, web: qbz.gov.al, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 50

⁹ QBZ, web: qbz.gov.al, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 51

¹⁰ Shih Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 52, QBZ, web: qbz.gov.al

¹¹ Shih Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 54/1, QBZ, web: qbz.gov.al

¹² Shih Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 55, QBZ, web: qbz.gov.al

¹³ QBZ, web: qbz.gov.al, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 59

¹⁴ QBZ, web: qbz.gov.al, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 57

ne normat pergjithesisht te pranuar te se drejtes nderkombetare.¹⁵ Kodi i Punes ka pesuar ndryshime te shumta me Ligjin nr.136/2015 i cili ka hyre ne fuqi me 22.06.2016. Keto ndryshime ishin pothuajse gjithepershireshe dhe u reflektuan edhe ne dispozitat per mbrojtjen e vecante te punemarresve te kategorive te vecanta, mbrojtjen nga diskriminimi ne punesim, trajtimin e barabarte ne pune dhe mbrojtjen teresore te punemarresve ne kushte specifike.

Ne baze te dispozitave te Kodit te Punes ndalohet puna e detyruar, diskriminimi ne punesim, garantohet liria sindikale dhe bisedimet kolektive, rregullohet kontrata individuale e punes, kontratat e vecanta te punes gjithashtu, rregullohen detyrimet e paleve dhe pergjegjesite perkatese qe mund te burojne gjate kesaj marredhenie, percaktohen detyrimet ne fushen e sigurise dh eshendetit ne pune, rregullohet menyra e mbrojtjes se kategorive te vecante ne pune si femijet, grate shtatzena dhe nenat me femije ne gji, rregullohet koha e punes dhe e pushimeve, e lejes prinderore gjithashtu, rregullohet paga e punes, percaktohen menytrat e posacme te mbrojtjes se pagave dhe garantohet trajtimi i barabarte ne shperblim, garantohet mbrojtja e punemarresve nga ndryshimet e marredhenies se punes dhe largimet nga puna, rregullohet organizimi kolektiv dhe garantohet e drejta sindikale, percaktohen bisedimet kolektive dhe etapat e lidhjes se kontrates kolektive, rregullohet e drejta e greves dhe kushtet e ligjshmerise se saj.

Nder ligjet e tjera qe rregullojne **marredheniet e punes ne sektore te vecante** permendim: Ligji Nr 152/2013 i ndryshuar ne vitin 2017 “Per Nepunesin civil”, i cili zbatohet per cdo nepunes qe ushtron funksion publik ne nje institucion te administrates shteterore, institucion te pavarur apo njesite e qeverisjes vendore, me perjashtime te caktuara.¹⁶

Po keshtu rregullime te vecanta te marredhenies se punes dhe funksionit permendim Ligjin 59/2017 “Per karrieren ne forcat e armatosura te Republikes se Shqiperise”, Ligji 108/2014 “Per policine e shtetit”, Ligji 152/2015 “Per sherbimet e mbrojtjes nga zjarri”, Ligji “Per kujdesin shendetesor”, Ligji “Per systemin parauniversitar”, Ligji “ Per policine bashkiake”, Ligji 10433, dt 16.06. 2011, “Per inspektimin ne Republikën e Shqiperise”, etj

Ligji “Per inspektimin ne Republikën e Shqiperise”, **percakton parime e pergjithshme te inspektimit ne pune**, organizimin e institucioneve publike, qe kryejne funksione inspektimi, statusin e inspektoreve, rregullat e procedimit administrative te inspektimit, dhe krijimin dhe funksionet e Inspektoratit Qendror te Punes.¹⁷Ne funksion te inspektimit ne pune zbatohet Ligji 9634, vitit 2006 “Per inspektimin ne pune”.

Siguria dhe shendetit ne pune, perpos dispozitave ne kreun perkates te Kodit te Punes, rregullohen ne menyre te posacme nga Ligji 10 237, dt 18.02.2010 “Per Sigurine dhe Shendetin ne Pune”, i cili percakton parimet baze ne fushen e sigurise dhe shendetit ne pune dhe rregullon ne menyre te vecante detyrimet perkatese te paleve te perfshira ne marredhenien e punes, si edhe mbrojtjen e kategorive te vecanta ne pune.

Dokumenti Strategjik per Sigurine dhe Shendetin ne Pune 2016-2020 i zbatuar pergjate harkut perkates kohor kishte per qellim zhvillimin e metejshem te politikave ne fushen e sigurise dhe shendetit ne pune, ne permiresimin e situates lidhur me aksidentet ne pune dhe semundjet profesionale.

Mbrojtja e vecante ne pune per veprimtari te vecanta rregullohet me ligje dhe akte te shumta nenligjore. Ligji Nr 135/2016 “Per sigurine dhe shendetin ne pune, emergjencat dhe shpetimin

¹⁵Ligj Nr 7961, date 12.07.1995, I ndryshuar, “Kodi I Punes se Republikes se Shqiperise”, Nenet: 1, 2/1/2

¹⁶Ligji Nr 152/2013 I ndryshuar, “Per Nepunesin civil” Neni 2

¹⁷Ligji 10433, dt 16.06. 2011, “Per inspektimin ne Republikën e Shqiperise”, Neni 1

ne veprimtarine minerare dhe ne punimet nentokesore ne veprat hidro-energjitike” percakton parimet e pergjithshme te mbrojtjes dhe sigurine ne pune ne sektorin e punimeve minerare dhe nentokesore ne hidroenergjitike me qellim sigurine dhe jeten e shendetin e punemarresve te punesuar ne kete sektor.

Ne drejtim te punesimit dhe tregut te punes, rregullimet behen nga Ligji 15/2019 “Per nxitjen e punesimit”, i cili rregullon sherbimet e punesimit, programet ne tregun e punes, si edhe funksionet e organeve perkatese per administrimin e ketyre programeve.

Strategjia Kombetare per Punesim dhe Aftesi 2019- 2022, publikuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomise eshte vazhdim i Strategjia Kombetare per Punesim dhe Aftesi 2014- 2018, ku objektivat strategjike jane te ngjashem por tashme ne strategjine ne zbatim ata synojne te perfundojne proceset e pambyllura ne objektivat e strategjise pararendese.

Strategjia Kombetare per Punesim dhe Aftesi 2019- 2022, ka per qellim:

- Te nxise mundesite per punen e denje, nepermjet politikave te frytshme ne tregun e punes;
- Te ofroje arsim dhe formim profesional cilesor per te rinjte dhe te rriturit;
- Te nxise perfshirjen sociale dhe kohezionin territorial; si edhe
- Te fuqizoj qeverisjen e tregut te punes dhe te sistemeve kualifikuese;

Lidhur me **parimin e mbrojtjes nga diskriminimi**, Ligji 10 221, date 04.02.2010 “Per mbrojtjen nga diskriminimi” plotesisht i perafruar me direktivat e Bashkimit European, ne Kreun II te tij rregullon dh etrajton ndalimin e diskriminimit ne punesimt e cdo personi duke percaktuar detyrimet e punedhenesve ne kete drejtim dhe te drejtat e punemarresve.

Po keshtu, ne kete drejtim permendim ligjin 9970, date 24.07.2008 “Per barazine gjinore” dispozitat e te cilit rregullojne trajtimin e barabarte te burrave dhe grave me qellim krijimin e mundesive te barabarta ne te gjitha fushat.

Ne menyre te vecante, perpos rregullimeve te tjera ne kodin e punes dhe akte nenligjore, ne drejtim te **mbrojtjes se personave me aftesite kufizuar** eshte miratuar dhe zbatohet Ligji 93/2014 “Per perfshirjen dhe aksesueshmerine e personave me aftesi te kufizuar”. Dispozitat e ketij ligji synojne te ofrojne mundesi te barabarta per personat me aftesi te kufizuar ne kushte te barabarta me te tjeret.

Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise rregullimet behet nga Ligji i vitit 1993, i ndryshuar, “Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise” i cili rregullon sigurimet shoqerore te cilat perfshijne sigurimin e detyrueshem, sigurimin vullnetar, suplementar dhe pensionet e posacme.

Po keshtu, me ligj te vecante rregullohet sigurimi shendetesor i detyrueshem, perkatesisht Ligji nr 10383, date 24.02.2011 “Per sigurimin e detyrueshem te kujdesit shendetesor ne Republiken e Shqiperise”. Ligji i vitit 2011 rregullon statusin e personave invalide paraplegjike dhe tetraplegjike. Nje sere ligjesh te tjere dhe aktesh nenligjore rregullojne sistemin e sigurimit shoqeror dhe shendetesor ne Shqiperi.

2.3 INSTITUCIONET PËR USHTRIMIN DHE MBROJTJEN E TË DREJTAVE THEMELORE NE KAPITULLIN 19

Ministria e Financave dhe e Ekonomise eshte struktura pergjegjese per zbatimin e nje sere politikash lidhur me punesimin. Prane kesaj ministrie, nen varesine e Drejtorise se Pergjithshme te Politikave te Makroekonomise, Ceshtjeve Fiskale dhe Punesimit funksioni i se ciles eshte te drejtoje politikat ne drejtim te zhvillimit ekonomik te vendit, eshte krijuar dhe funksionon Drejtoria e Politikave te Punesimit dhe Aftesimit Profesional. Kjo strukture funksionon e ndare ne tri seksione kryesore, veprimtria e te cilave konkretisht ka te beje me:

- Sektori i Arsimit Profesional;
- Sektori i Politikave te Punesimit dhe Migratore;
- Sektori i Sigurimeve Shoqerore dhe Pages Minimale;

Inspektorati Shteteror i Punes dhe Sherbimeve Shoqerore eshte organ i qeverisjes qendrore, ne varesi te Ministrise se Financave dhe e Ekonomise. Funksioni kryesor i kesaj strukture eshte inspektimi ne baze te te gjitha procedurave ligjore dhe ne zbatim te ligjit per inspektimin.¹⁸

Inspektorati i Punes eshte organi pergjegjes per kontrollin e zbatueshmerise se dispozitave te legjislacionit te punes ne permbushjen e detyrimeve ligjore nga punedhenesit dhe punemarresit. Po keshtu, misioni i kesaj strukture eshte keshillimi, zbutja e konflikteve, parandalimi dhe marrja e sanksioneve ndaj subjeteve qe shkelin ligjin.

Ne Inspektoratin Shteteror te Punes dhe Sherbimeve Shoqerore ushtrojne veprimtarine inspektuese 94 inspektore, 13 pergjegjes inspektimi, ne 13 rajone gjithsej, te strukturuara ne 6 Drejtori Rajonale.¹⁹ Numri total i personave te punesuar eshte 165. Inspektorati Shteteror i Punes dhe Sherbimeve Shoqerore perbehet nga 3 Drejtori, perkatesisht:

- Drejtoria e Inspektimit te Punes
- Drejtoria e Finances dhe Veprimtarive Mbeshtetese
- Drejtoria e Inspektimit te Standarteve dhe Sherbimeve Shoqerore

Puna e Inspektoratit te Punes eshte e mbeshtetur ne Ligji 9634, vitit 2006 “ Per inspektimin ne pune”, Ligji 10433, dt 16.06. 2011, “Per inspektimin ne Republiken e Shqiperise” dhe nje sere instrumentash nderkombetare gjithashtu: Konventa nr 81 e Organizates Nderkombetare te Punes “Per inspektimin e punes”; Konventa nr 129 e Organizates Nderkombetare te Punes “Inspektimin i punes ne bujqesi”; Konventa nr 155 e Organizates Nderkombetare te Punes “Siguria dhe shendetit ne pune”;

¹⁸Ligji 10433, dt 16.06. 2011, “Per inspektimin ne Republiken e Shqiperise”, Ligji 9634/2006 “ Per inspektimin ne pune”.

¹⁹Analize Pune Viti 2021, publikuar ne: www.inspektoratipunes.gov.al, ne vitin 2022, Inspektorati Shteteror I punes dhe Sherbimeve Shoqerore

KESHILLI KOMBETAR I PUNES

Krijimi dhe funksionimi i këtij organi të rendesishëm konsultativ rregullohet me dispozitat e Kodit të Punës. Ky keshill perbehet nga perfaqesues te punemarresve, perfaqesues te punedhenesve dhe perfaqesues te Qeverise. Konsultimet lidhen me ceshtje sikurse: ndryshimet e legjislacionit te punes, percaktimet e politikave lidhur me mbrojtjen ne pune, punesimin, formimin dhe kualifikimin profesional, si dhe me zbatimin e standarteve të Organizatës Ndërkombëtare të Punës

Rregulla te vecanta per menyren e zgjedhjes se antareve te tij dhe menyren e funksionimit

Këshilli Kombëtar i Punës përbëhet nga 27 anëtarë dhe 27 kandidatë, nga 10 përfaqësues anëtarë dhe 10 përfaqësues kandidatë nga organizatat e punëdhënësve, nga 10 përfaqësues anëtarë dhe 10 përfaqësues kandidatë nga organizatat sindikale dhe nga 7 përfaqësues anëtarë dhe 7 përfaqësues kandidatë të Këshillit të Ministrave. Përfaqësuesit kandidatë marrin pjesë në seancat e keshillit, në mungesë të përfaqësuesve anëtarë.²⁰

Përfaqësuesit e qeverisë janë Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë; e Arsimit dhe Sportit; e Drejtësisë; e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes; e Turizmit dhe Zhvillimit Urban.

Kodi i Punës, pas ndryshimeve me Ligjin 136/2015 rregullon edhe krijimin në çdo qark të **Këshilli Konsultativ Trepalësh Rajonal**, në përberje të të cilit janë përfaqësues të organizatave të punëdhënësve, të sindikatave të punemarresve dhe përfaqësues të strukturave shtetërore. Këshilli Konsultativ Trepalësh Rajonal përbëhet nga 15 anëtarë dhe 15 anëtarë zëvendësues, perkatesisht 5 anëtarë dhe 5 anëtarë zëvendësues nga organizatat sindikale; 5 anëtarë dhe 5 anëtarë zëvendësues nga organizatat e punëdhënësve; 5 anëtarë dhe 5 anëtarë zëvendësues me përfaqësim nga organet e qeverisjes vendore.²¹ Ky keshill shqyrton ceshtje ne interes te paleve me qellim permiresimin e marredhenies midis tyre.

INSPEKTORATI I PUNES DHE SHERBIMEVE SHOQERORE

Inspektoriati i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është struktura administrative qendrore në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Ky institucion është krijuar në vitin 1994 me Vendim të Keshillit të Ministrave.

Ky organ ushtron veprimatrinë e tij bazuar në ligj dhe ka për qëllim inspektimin lidhur me kontrollin e zbatueshmërisë së legjislacionit të punës dhe mbrojtjen në pune në të gjitha aspektet.²² Krahas fushës së inspektimit të punës, pjesë përbërëse e Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ushtron veprimtarinë e tij inspektuese edhe lidhur me respektimin e standarteve të shërbimeve Shoqërore, përfshirë standartet e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

²⁰Ligj Nr 7961, date 12.07.1995, I ndryshuar, “Kodi I Punës së Republikës së Shqipërisë”, Neni 200/4

²¹Ligj Nr 7961, date 12.07.1995, I ndryshuar, “Kodi I Punës së Republikës së Shqipërisë”, Neni 201/1

²²Inspektoriati i punës ushtron funksionet e tij në bazë të Ligjit 10433/2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe Ligjit 9634/2006 “Për Inspektimin e Punës”, i ndryshuar

Misioni i përgjithshëm i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është: kontrolli, konstatimi, këshillimi, njoftimi, formimi, zbutja e konflikteve, parandalimi dhe sanksionimi.²³

Ne baze të Ligjit 9634/2006 “Për Inspektimin e Punës”, i ndryshuar, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ngarkohet:

- Të sigurojë zbatimin e dispozitave ligjore për kushtet e punës dhe mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, për kohëzgjatjen e punës, pagat, sigurimin, higjienën dhe mirëqenien, punësimin e fëmijëve, të të miturve dhe grave, si dhe për çështje të tjera, që lidhen ngushtë me to, në atë masë, që inspektorët e punës ngarkohen të sigurojnë zbatimin e këtyre dispozitave.
- T’u japë të dhëna dhe këshilla teknike punëdhënësit dhe punëmarrësit për mjetet më efikase të shqyrtimit të dispozitave ligjore.
- Të vërë në dijeni autoritetin përgjegjës për mangësitë dhe abuzimet, që nuk mbulohen në mënyrë të veçantë nga dispozitat ligjore në fuqi, si dhe të propozojë mjetet dhe instrumentet e nevojshme për përmirësimin e gjendjes.
- Të sigurojë respektimin e kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror²⁴

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore funksionon duke përcaktuar me se fundmi strukturën e re. Ky organ ushtron funksionet e tij inspektuese duke pasur të punësuar 94 inspektorë pune terreni, 13 përgjegjës sektori të cilet veprojnë në 13 rajone të organizuara në 6 Drejtori Rajonale. Struktura dhe organika e re e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është miratuar në vitin 2021 në zbatim të Urdhrit nr.156/2020 të Kreut të Qeverisë, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”. Te punësuarit pranë kësaj strukture janë totalisht 165.

AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT

Agjencia Kombetare e Punesimit është një strukturë e posaçme administrative, në varësi të ministrit përgjegjës për punësimin dhe zhvillimin e aftësive. Agjencia Kombetare e Punesimit është krijuar dhe rregullon veprimtarinë e saj, bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, si edhe Ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin profesional në RSH”, si edhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”.

Agjencia Kombetare e Punesimit është strukturë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të punësimit, të vetëpunësimit dhe të arsimit e formimit profesional dhe zhvillimit të aftësive. Kjo Agjenci zhvillon veprimtarinë e saj në nivel qendror po edhe rajonal nepermjet Zyrrave Rajonale dhe Vendore të Punësimit, Drejtorive Rajonale të Formimit Profesional Publik si edhe Shkollave të Arsimit Profesional Publik.

Agjencia Kombetare e Punesimit garanton nivelin e cilësisë së shërbimeve të ofruara për punësimin, vetëpunësimin dhe arsimin e formimin profesional, nëpërmjet monitorimit dhe vlerësimit; organizon punën për administrimin dhe zbatimin e programeve aktive e passive të tregut të punës; organizon punën për administrimin e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional (AFP), sipas legjisllacionit në fuqi për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e

²³ Shih Ligji 9634/2006 “Për Inspektimin e Punës”, i ndryshuar, Neni 6/1

²⁴ Shih Ligji 9634/2006 “Për Inspektimin e Punës”, i ndryshuar, Neni 6/2

Shqipërisë; organizon punën për menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e drejtorive rajonale, të zyrave vendore dhe të ofruesve publikë të arsimit e formimit profesional; siguron se funksionet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar për drejtoritë rajonale, zyrat vendore dhe ofruesit publikë të arsimit dhe formimit profesional, kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.²⁵

KOMISIONERI PER MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është autoriteti përgjegjës, i krijuar dhe që funksionon në bazë të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Ky institucion siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Komisioneri paraqet raport të paktën njëherë në vit përpara Komisioneve të Kuvendit, si dhe përgatit raporte mbi aktivitetet e 6 mujorit të parë të vitit të veprimtarisë institucionale.²⁶ Komisioneri e mbështet punën e tij në zbatimin e të gjithë mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.

Ky autoritet ushtron funksionet e tij, duke konsideruar aktet ndërkombëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Punës të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë lidhur me trajtimin e barabartë në punë, ndalimin e diskriminimit në punë, etj. Në drejtim të ndalimit të diskriminimit përmendim Konventën për Shpërblimin e Barabartë (Nr. 100) dhe Rekomandimin (Nr. 90), 1951 dhe Konventën për Diskriminimin (Punësimi dhe Profesionet) (Nr. 111) dhe Rekomandimin (Nr. 111), 1958, Konventën për dhunën dhe ngacmimin, 190, është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, me Ligjin Nr. 13/2022.

Po kështu, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi u referohet standardeve të Bashkimit Europian lidhur me respektimin e barazisë, përfshirë ndalimin e diskriminimit në punë.

INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE

Instituti i Sigurimeve Shoqërore është institucion publik, qëllimi i të cilit është mbrojtja sociale nepermjet administrimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shpërndarjes së përfitimeve. Funksionimi i këtij institucioni rregullohet me Ligjin 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. MONITORIMI I KOMISIONIT EVROPIAN: SUNDIMI I LIGJIT NË KAPITULLI 19

3.1 Vlerësimi i arritjeve lidhur me Kapitullin 23

Në rrugetimin e saj për t’iu bashkuar familjes europiane, Shqipëria është angazhuar teresisht jo vetëm në përfaqësimin e plotë të standardeve të legjislacionit të Bashkimit Europian, por edhe në zbatimin e tyre duke konsideruar kështu vlerat më të larta themelore të BE-së në përfshirje gjithashtu të

- reformes në sistemin gjyqësor,
- luftes kundër korrupsionit,

²⁵ Shih Fletorja Zyrtare nr 114, viti 2019, VKM Nr 554, date 31.07.2019 “Për krijimin, menyrën e organizimit dhe funksionimin të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, II/1

²⁶ Bazuar në Ligjin Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, Neni 26

- respektimit te të drejtave themelore të garantuara nga kuadri ligjor i Bashkimit European

Ne vleresiminin e Komisionit European per vitin 2014-2015 rezulton se Shqiperia po ndermerr hapa ne drejtimi te reformes ne drejtesi, duke iu drejtuar edhe Komisionit te Venecias. Hartohet Strategjia 2014-2020 per reformen ne sistemin e drejtesise me qellim garantimin e pavaresise, profesionalizmit dh pergjegjesise.²⁷

Reforma teresore ne sistemin e drejtesise eshte e bazuar ne ndryshimet ligjore qe kane shenuar tashme ngritjen e nje sistemi teresisht funksional dhe eficient. Kjo reforme eshte e lidhur me krijimin e organeve te reja te qeverisjes se pushtetit gjyqesor, krijimin e strukturave per zhvillimin e procesit te rivleresimit kalimtar, ngritjen e strukturave anti-korrupsion sikurse Byroja Kombetare e Hetimit, dhe Prokuroria e Posacme Kunder Korrupsionit.

Nje sere strukturash dhe organesh te reja kushtetuese u ngriten ne kuader te reformes ne drejtesi, respektimit te te drejtave dhe parimevet hemelore, si edhe ne luften kunder krimin te organizuar dhe korrupsionit. Ngritja dhe funksionet kryesore te ketyre organeve u pasqyruan ne ndryshimet e Kushtetutes se Republikes se Shqiperise me Ligjin Nr 76/2016, date 22.07.2016.

Ne Raportin e Komisionit te Europes paraqitur Parlamentit European ne Strasbourg per vitin 2021 thuhet se Shqiperia ka bere progress te mire lidhur me reformen ne drejtesi. Gjykata Kushtetuese i eshte rikthyer funksionalitetit te plote te saj me zhvillimin e procesit per emerimin e tri anetareve te rinj te saj ne vitin 2020. Ne Gjykate e Larte u emeruan 6 emerimet e reja pas zhvillimit te procedures se kerkuar me ligj, procedure e cila u realizua ne Mars te vitit 2021.

Sipas raportit rezultate jane shenuar edhe ne drejtim te luftes kunder korrupsionit, megjithese mbetet ende pune per tu bere lidhur me konfiskimin e aseteve te perfituara nga aktet korruptive. Raporti cileson se progress eshte bere edhe ne drejtim te procesi tte vetting-ut ne sistemin e drejtesise pavaresisht ndikimit te Covid-19. Operacioni Nderkombetar i Monitorimit vazhdon te monitoroje procesin e vettingut ne sistemin e drejtesise.

Rekomandime u bene ne kete raport vleresimi nga Komisioni i Europes duke kerkuar vazhdimin e reformave ne drejtim te procesit te rivleresimit, konsolidimit te kapaciteteve ne sistemin e drejtesise dhe perfundimit te procesit per implementimin e hartes se re gjyqesore.

Ne kuader te luftes anti-korrupsion, vlen te permendet krijimi i Drejtorise Anti-korrupsion ne Ministrine e Drejtesise dhe riaktivizimi i struktures se posacme se Taskes Forces kunder Korrupsionit.

Nga hetimet e zhvilluara nga struktura e posacme te ngritura kunder korrupsionit per vitin 2020 jane derguar ne gjykate 413 raste, perkundrejt 643 rasteve ne vitin 2019. Po keshtu, 270 persona rezultojne te denuar nga gjykatat e shkalles se pare per vitin 2020, 262 te denuar ne vitin 2019 dhe 87 persona te denuar me vendim gjyqesor nga gjykatat e apelit. Shqiperia eshte vleresuar ne drejtim te perqasjes me te drejtat nderkombetare te njeriut pasi ka ratifikuar pjesen me te madhe te konventave per mbrojtjen e te drejtave dhe parimeve themelore.

²⁷ European Commission, Albania 2014 Report, 'Enlargement Strategy and Main Challenges 2014-15', 08.10.2014

Vlen të theksohet se është permiresuar rregullimi ligjor për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara dhe barazine gjinore. Lidhur me barazine gjinore në Shqipëri, në Qershor të vitit 2021 është miratuar për të zbatuar Strategjia mbi Barazine Gjinore 2021-2030. Indeksi i Barazisë Gjinore për Shqipërinë, publikuar në vitin 2020 arriti në 60.4, duke shënuar ‘gender gap’ prej 7.4 pikësh në mesataren e Bashkimit Europian (67.4)²⁸

Lidhur me parimin për ndalimin e diskriminimit, korniza ligjore është e përafër me standartet e Bashkimit Europian. Gjithashtu, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka pësuar ndryshime të cilat u referohen konkretisht: terminologjise së përdorur në dispozitat ligjore, kategorive lidhur me rregullime ligjore, si edhe procedurave. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka trajtuar përgjate kësaj periudhe një numër të konsiderueshëm çështjesh lidhur me diskriminimin, pjesa më e madhe e të cilave u referohet shërbimeve dhe punësimit.²⁹

Është permiresuar kuadri ligjor lidhur me të drejtat e femijeve megjithëse kërkohet të forcohen kapacitetet institucionale lidhur me mbrojtjen e temiturve. Në këtë aspekt, në Shtator 2020 është miratuar Plan i Kombëtar i Veprimit. Mbrojtja e femijeve është permiresuar rëndësisht me miratimin e Ligjit “Për të drejtat dhe mbrojtjen e femijes”, si edhe ndryshimet e Ligjit për Dhunen në Familje.

Lidhur me Mbrojtjen e Personave me aftësi të kufizuara, pas zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit 2016-2020, një plan i ri kombëtar për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara 2021-2025 është miratuar në Maj 2021. Në Raportin e Komisionit të Europës paraqitur Parlamentit Europian në Bruksel për vitin 2022 çështet progresi i bërë zbatimin e standarteve ligjore dhe reformën në drejtësi. Në kuadër të reformimit, kanë vazhduar emerimet në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese.

Përpjekje të vazhdueshme kërkohen nga raporti në drejtësi të luftës anti-korrupsion në nivele të larta, si edhe mbrojtjes së të dhenave personale në përshtatje me legjislacionin e Bashkimit Europian.³⁰ Lidhur me procesin e vettingut në sistemin e drejtësisë, rezultoi se sipas të dhenave të deritanishme, 64% e dosjeve të shqyrtuara nga strukturat përkatëse të vettingut kanë përfunduar me përfundime, doreheqje apo përfundim të mandatit për magistratet.

Strukturat e Specializuara Anti-Korrupsion dhe Gjykatat për Krimin e Organizuar kanë marrë disa vendime të rëndësishme lidhur me denimin e zyrtareve të lartë. Nder dokumentat strategjike në drejtësi të luftës anti-korrupsion zbatohet plani i veprimit ndër-sektorial 2021-2022 i cili është aktualisht në zbatim. Progres kërkohet në drejtësi të forcimit dhe rritjes së kapaciteteve për zbatimin e akteve ligjore kundër dhunës ndaj grave.

3.2 VLERESIMI I ARRITJEVE LIDHUR ME KAPITULLIN 19

Pasi Shqipëria në vitin 2009 paraqiti kërkesën e saj për të anëtarësuar në Bashkimin Europian, në vitin 2012 Komisioni rekomandoi që Shqipëria të jepej statusi i vendit kandidat në

²⁸European Commission, Albania 2021 Report, Communication on EU Enlargement Policy, Strasbourg, 19.10.2021

²⁹European Commission, Albania 2021 Report, Communication on EU Enlargement Policy, Strasbourg, 19.10.2021

³⁰European Commission, Albania 2022 Report, Communication on EU Enlargement Policy, Brussels, 12.10.2022

permbushje te reformave lidhur me reformimin e administrates publike dhe sistemit te drejtesise ne teresi.

Procesi i reformimit dhe pershtatjes lidhur me integrimin shenon nje hap te rendesishem kur Shqiperise i jepet statusi i vendit kandidat në qershor të vitit 2014 nga Këshilli European. Pas Vendimit te Keshillit European, ne 26 mars 2020 per nisjen e negociatave te anetaresimit me Shqiperine ne Bruksel zhvillohet Konferenca Nderqeveritare ne korrik 2022 per hapjen e negociatave dhe nisjen e procesit ‘screening’.

Pas përmbushjes së prioriteteve sikurse reformimi i administrates publike, lufta kunder korrupsionit dhe krimin te organizuar, reformimi i sistemit te drejtesise dhe mbrojtja e te drejtave te njeriut, Komisioni European monitoron procesin e miratimit dhe zbatimin e të gjithë *acquis* së Bashkimit European, i cili ndahet në 35 kapituj, nje nder te cilet, ashtu sikurse ne kete material eshte trajtuar ne disa aspekte eshte edhe kapitulli 19 lidhur me politikave sociale dhe punesimin. Kjo pjese e analizes ka te beje me ecurine dhe zhvillimin e progresit lidhur me reformimin e politikave sociale dhe punesimin.

VLERESIMI PER PERIUDHEN 2012-2014

Ne vleresimin per vitin 2012, Komisioni European vlereson se duhen ndryshime te shumta ne legjislacionin e punes dhe politikave sociale ne teresi.³¹ Organizimi i struktures se Inspektoratit Shteteror te Punes ishte permiresuar me krijimin e Drejtorise se Standarteve dhe Inspektimit te Sherbimeve Shoqerore megjithese ne kete kohe mbetet domosdoshmeri forcimi i kapaciteteve profesionale dhe permiresimi i funksionit ne zbatimin e legjislacionit. Keshilli Tripalesh per Shanset e Barabarta krijohet prane Keshillit Kombetar te Punes, megjithese KKP (Keshilli Kombetar i Punes-NLC) duhet te funksionojne ne baze te kriterave te perfaqesimit te cilat duhet te perqasen me standartet e Organizates Nderkombetare te Punes.

Ne vleresimin e vitit 2012 dhe ne vleresimin per 2013 gjithashtu³² kerkohet permiresimi i kushteve te punes, shendetit dhe sigurise ne pune, nderkohe qe forcimi i bashkepunimit dhe zhvillimi i dialogut social midis paleve mbetet prioritet. Zhvillimi i negociatave per lidhjen e kontratave kolektive mbetet i dobet pergjate kesaj periudhe. Pergjate periudhes 2012, 2013, 2014 tregu i punes vleresohet se duhet te permiresohet lidhur me zhvillimin e politikave te punesimit, zbatimin e plan veprimit per punesimin e terinjve, permiresimin e pjesemarrjes se grave ne tregun e punes dhe permiresim te politikave per punesimin e kategorive te vecanta dhe minoriteteve. Vleresohet gjithashtu se mbrojtja e femijeve duhet te konsiderohet me prioritet te larte pas nga nje monitorim i situates tregon se 7.7% e femijeve shqiptare te moshes 5-17 vjec punojne. Sa i takon politikave te puneismit, hartohet dhe zbatohet Strategjia e Punesimit 2014-2020.

Ne vitin 2013 zhvillohen pergatitjet per European Social Fund dhe hartohet Strategjia e re per Mbrojtjen Sociale 2013-2020. Ne vitin 2012 miratohen ndryshimet ne Ligjin Per Kontributin e Detyrueshem. Duke konsideruar nivelin e ulet te njohjes se te drejtave edhe menyrate te mbrojtjes lidhur me ndalimin e diskriminimit dhe trajtimin e barabarte gjinor, Komisioneri per

³¹European Commission, Albania 2022 Report, Enlargement Strategy and Main Challenges 2012-2013, Brussels, 10.10.2012

³² European Commission, Enlargement Strategy and Main Challenges 2013-2014, Brussels, 16.10.2013

Mbrojtjen nga Diskriminimi zhvillon aktivitetet lidhur me ndergjegjesimin ne shoqeri dhe nenshkruan marreveshje bashkepunimi me institucione ne nivel qendror dhe lokal. Vleresohet se ligji per mbrojtjen nga diskriminimi eshte i perafruar me standartet e legjislacionit te Bashkimit European, por kerkohet forcimi i zbatimit te tij. Lidhur me mbrojtjen e personave me aftesi te kufizuar pritet miratimi i Ligjit Per te Drejtat e Personave me Aftesi te kufizuara.

VLERESIMI PER PERIUDHEN 2014-2017

Ne fushen e sigurise dhe shendetit ne pune ne Janar dhe Shkurt te vitit 2014 Shqiperia miraton Konventat e Organizates Nderkombetare te Punes per sigurine ne pune ne sektore te vecante. Rregullime te reja ne perqasje te plote me acquis e Bashkimit European u miratuan ne fushen e sigurise dhe shendetit ne pune, nderkohe qe pergatitet Strategjia Kombetare Per Sigurine dhe Shendetin ne Pune. Inspektoret e Punes u jane nenshtruar trainimeve te vecanta lidhur me procedurat e inspektimit, menytrat e inspektimit, respektimin e kodit te etikes dhe legjislacionin e Bashkimit European.³³ Inspektorati Shteteror i Punes permireson metodat e mbledhjes dhe perpunimit te statistikave, si edhe monitorimin e inspektimeve. Ne vitin 2015 kater rregullime te reja ne perqasje te plote me ‘acquis’ u miratuan lidhur me sigurine dhe shendetin ne pune per punemarresit qe punojne nen ndikimin e rrezatimeve elektromagnetike, rrezatimeve optike, zhurmave dhe dridhjeve. Po keshtu, pergjate kesaj periudhe u miratuan aktet nenligjore per sigurine ne pune te grave shtatzena, minatoreve dhe punonjesve te peshkimit.³⁴

Vleresohet miratimi i ligjit per Personat me Aftesite Kufizuara i cili gjithashtu parashikon ngritjen e Komitetit Shteteror per Personat me Aftesite Kufizuara, ne perberje te te cilit jane perfaqesues nga Ministri te ndryshme dhe nga shoqeria civile. Megjithese dialogu social eshte permiresuar, ende hapa te metejshem duhet te ndermerren lidhur me efikasitetin e negociatave kolektive dhe kontratat kolektive.³⁵

Lidhur me tregun e punes, raporti i Komisionit European per vitin 2016 cileson se prurjet e personave te arsimuar dhe diplomuar ne dege te vecanta nuk u pergjigjen kerkesave te tregut te punes dhe se fondet publike akorduar sektorit arsimor mbeten ende te ulta, ne nivelin 3% te GDP-se.³⁶

Ne Qershor te vitit 2016 hyjne ne fuqi ndryshimet e Kodit te Punes. Keto ndryshime ligjore kane per qellim transpozimin e direktivave te ndryshme te Bashkimit European, konkretisht lidhur me:

- Ndalimin e diskriminimit ne pune;
- Te drejtat prinderore;
- e drejta per informim;
- marredheniet punedhenes-punemarres dhe telepunen;
- moshen e punesimit qe rritet nga 14 ne 15 vjec ne perputhje me standartet e konventave te Organizates Nderkombetare te Punes;
- pushimet vjetore
- barazine midis burrave e grave ne pune

³³ European Commission, Albania 2014 Report, ‘Enlargement Strategy and Main Challenges 2014-15, 08.10.2014

³⁴European Commission, Albania 2015 Report, Brussels, 10.11.2015

³⁵ European Commission, Albania 2015 Report, Brussels, 10.11.2015

³⁶European Commission, Albania Report 2016, Brussels, 9.11.2016

- e drejta e reduktimit të kohës së punës pas lindjes së femijes
- rastet e lejes së papaguar

Megjithatë, përpos progresit në këto drejtim, sanksione duhet të parashikohen lidhur me shkeljen e parimit ndalimin e punës së detyruar. Lidhur me politikën e punësimit, vlen të përmendet Strategjia Kombëtare e Aftesimit dhe Punës 2014-2020 e cila është në zbatim.³⁷ Lidhur me European Social Fund nuk ka pasur zhvillime për gjatë kësaj periudhe. Vlen të përmendet gjithashtu miratimi i Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale dhe dokumenti politik 2015-2020.

VLERESIMI PËR PERIUDHËN 2017-2020

Lidhur me shëndetin dhe sigurinë në punë, në Shqipëri zbatohet Dokumenti Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në periudhën 2016-2020.³⁸ Shqipëria shënon progress në drejtim të përafërimit të legjislacionit të saj duke transpozuar direktivat e Bashkimit Europian, por zbatimi i këtij kuadri ligjor rezultoi i dobët për shkak të burimeve financiare dhe humane të kufizuara.³⁹

Megjithatë Ligji për Inspektimin në Punë pësoi ndryshime të miratuara në Mars 2017, kapacitetet profesionale, njerezore dhe teknike të Inspektoratit të Punës, si edhe bashkëveprimi me aktorët e tjerë mbeten ende të dobët. Sipas Inspektoratit të Punës informaliteti në tregun e punës është gjithashtu evident ku shifra më të larta janë regjistruar në sektorin e biznesit privat (42,2%), prodhimit (17,3%) dhe në atë tendërtimit (16,6%).⁴⁰

Dialogu social mbetet i dobët si në sektorin publik dhe atë privat.⁴¹ Këshilli Kombëtar i Punës, pas mbarimit të mandatit të anëtarëve të mëparshëm, riformohet në Prill të vitit 2018 megjithatë ende në akte ligjore nuk janë përcaktuar kriteret e qarta të përfaqësimit.⁴² Funksionimi i tij është i lidhur me zhvillimin e mëtejshëm me qëllim përmirësimit të situatës lidhur me kontratën kolektive.

Lidhur me politikën e punësimit, shkrihet Ministria e Punës e cila ishte struktura përgjegjëse për zbatimin e politikave të punësimit. Informaliteti në tregun e punës mbetet i lartë.⁴³ Komisioni Europian në raportin e vitit 2019 dhe të vitit 2020 shprehë se shkëmbimi i Ministrisë së Punës dhe kufizimi i angazhimit të burimeve njerezore ka ndikuar në skemën dhe politikën e punësimit. Ligji për Punësimin miratohet në Mars të vitit 2019, ndërkohë që miratohet kuadri ligjor plotësues. Në Korrik 2019 krijohet Agjencia Kombëtare e Punësimit e cila është struktura që do të administrojë zbatimin e politikave të punësimit dhe të aftesimit për punë, do të drejtojë

³⁷European Commission, Albania Report 2016, Brussels, 9.11.2016

³⁸European Commission, Albania 2018 Report, 2018 Communication on EU Enlargement Policy , Strasbourg, 17.4.2018

³⁹European Commission, Albania 2020 Report, 2020 Communication on EU Enlargement Policy, Brussels, 6.10.2020

⁴⁰European Commission, Albania 2020 Report, 2020 Communication on EU Enlargement Policy, Brussels, 6.10.2020

⁴¹ European Commission, Albania 2019 Report Brussels, 29.5.2019

⁴²European Commission, Albania 2020 Report, 2020 Communication on EU Enlargement Policy, Brussels,

⁴³European Commission, Albania 2018 Report, 2018 Communication on EU Enlargement Policy , Strasbourg, 17.4.2018

zyrat rajonale dhe lokale të punesimit, sikurse do të administroje sistemin e edukimit dhe trainimit profesional (VET-vocational education and training).⁴⁴

Lidhur me diskriminimin në punësim, ndryshimet ligjore në Kodin e Punës iu referuan barres se proves në rastet e ngacmimeve seksuale në vendin e punës. Sipas INSTAT, nga të dhënat e vitit 2018 rezultoi se 23% e grave janë të angazhuara në punë të papaguara të bizneseve familjare. Sipas Raportit të Komisionit Europian të vitit 2020 thuhet se 'gender pay gap' arriti në 10.1 % për vitin 2019 krahasuar me 10.7% që ishte në vitin 2018. Cëlohet gjithashtu se Shqipëria për herë të parë publikon Index-in Gjnor duke vlerësuar barazimin gjinor në 6 fusha perfishire edhe punën gjithashtu. Indexi lidhur me barazimin gjinor për Shqipërinë arriti në 60,4% për vitin 2017.

Shqipëria zbaton Planin Kombëtar të Veprimit për Mbrojtjen e Femijëve nga shfrytëzimi me qëllim përfitimin 2019-2021. Ligji për të Drejtat dhe Mbrojtjen e femijëve ka hyrë në fuqi në Shkurt 2017. Ligji për Sherbimet e Kujdesit Social ka hyrë në fuqi në Nëntor 2016, dhe Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020 zbatohet përgjate kësaj periudhe dhe zbatimi i saj është zgjidhur në kohë deri në 2023. Mbulimi nga kontratat kolektive rezultoi me një lartësi në sektorin publik në masën 73,7% të të punësuarve, ndërkohë që sistemi i zgjidhjes së konflikteve të punës duhet konsideruar. Në vitin 2019 qeveria krijoi mekanizmin për 'Social Fund' si një masë tranzitore për të menaxhuar shpërndarjen e fondeve nga buxheti i shtetit, si edhe ndërmerr masa për mbrojtjen e kategorive të vecanta për shkak të Pasojave të krijuara nga Covid 19.⁴⁵

VLERËSIMI EKZISTUES I SUNDIMIT TË LIGJIT NË KAPITULLI 19

4.1 LIGJI I PUNËS

Legjislacioni i punës ka pësuar ndryshime të shumta përgjate viteve të fundit me qëllim për afrimin e tij me kuadrin ligjor 'acquis' të Bashkimit Europian. Kodi i punës pësoi ndryshime pothuajse në të gjithë institutet juridike të ligjore që janë pjesë integrale e tij, ndryshime të cilat hyjnë në fuqi në vitin 2016. Konfliktet që lindin midis paleve të përfshira në marrëdhënien e punës dhe nga moszbatimi të detyrimeve sipas ligjit zgjidhen në pjesën më të madhe nga gjykatat, ndërkohë që zgjidhjet e konflikteve me ndërmjetësim konsiderohen një alternativë e dobishme e cila aktualisht është duke iu nënshtuar procesit të promovimit dhe ndergjegjesimit të aktoreve sociale. Pjesa më e madhe e konflikteve që burojnë nga marrëdhëniet e punës, ka të bëjë në një pjesë të konsiderueshme të çështjeve, me zgjidhjet e njëanshme të kontratave individuale të punës. Ky realitet pasqyrohet nevojën e ndergjegjesimit të paleve për të drejtat e tyre të punës dhe të drejtat sociale, si edhe nevojën për forcimin e besimit të sistemi i drejtësisë, i cili tashmë i është nënshtuar një procesi të thellë reformues.

Inspektorati Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është institucioni përgjegjës për kryerjen e inspektimeve për monitorimin dhe kontrollin e zbatueshmërisë së dispozitave të

⁴⁴European Commission, Albania 2020 Report, 2020 Communication on EU Enlargement Policy, Brussels, 6.10.2020

⁴⁵European Commission, Albania 2020 Report, 2020 Communication on EU Enlargement Policy, Brussels, 6.10.2020

legjislacionit te punes, si edhe per marrjen e masave ndeshkuese me karakter administrative ndaj subjekteve qe shkelin dispozitat per mbrojtjen ne pune. Kjo strukture e cila i eshte nenshtuar reformimit te saj me qellim garantimin e eficences se procesit inspektues te saj , ka shtuar ne strukturen e saj edhe Departamentin e Vleresimit te Riskut dhe tashme vepron me 94 inspektore. Reformimi i ketij institucioni te rendesishem eshte bere me Urdhrin nr. 156, datë 24.11.2020 të Kryeministrit, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”.⁴⁶Aktualisht numerohen rreth 166 mijë subjekte aktive, që janë object kontrollii ISHPSHSH-së, dhe sipas te dhenave nga INSTAT, Inspektorati i Punes dhe i Sherbimeve Shoqerore ka inspektuar 4.2 % të tyre.⁴⁷

Pas aktivitetit te ulet teI nspektoratit per shkak te pandemise se shkaktuar nga Covid 19, per vitin 2021 numri i inspektimeve me procedure standartene nivelin 7039 subjekte ekonomike private e shtetërore.⁴⁸ Spas Analizes Vjetore te Inspektoratit te Punes dhe Sherbimeve Shoqerore per vitin 2021 rezulton se pergjate vitit 2021 janë evidentuar 1092 punëmarrës informal ku gjatë procesit të inspektimit janë siguruar 1041 prejtyre, nëpërmjet masës urgjente “pezullim” të aktivitetit deri në sigurimin e tyre. Ndërkohë të pasiguarit janë raportuar pranë zyrave të tatim-taksave.

Sa i takon masave ndeshkimore te ndermarra nga Inspektorati rezulton se: 1440 masa administrative janë vendosur në subjektet ekonomike të inspektuara, ku: 524 janë masa urgjente për shkelje të marrëdhënive të punës, 54 janë masa urgjente për shkelje të sigurisë dhe shëndetit në punë, 760 janë masa të dënimit kryesor paralajmërim, 102 janë masa të dënimit kryesor gjobë.⁴⁹

Sipas rekomandimeve te Komisionit European ne raport vleresimin per Shqiperine per vitin 2021 dhe vitin 2022 kerkohet qe nevojiten hapa te metejshem per forcimin e kapaciteteve profesionale, dhe infrastrukture te Inspektoratit Shteteror te Punes.⁵⁰ Kerkohet gjithashtu trajnimi ne vazhdimesi i inspektoreve te punes per zbatimin e ligjit sipas standarteve te percaktuar nga Bashkimi European, si edhe forcimi i bashkepunimit tripalesh me organizatat e punemarresve dhe te punedhenesve. Lidhur me monitorimin e punes se femijeve dhe shfrytëzimin e tyre, Komisioni European kerkon bashkepunim me te ngushte midis Agjencise per Mbrojtjen e te Drejtave te Femijeve dhe Inspektoratit Shteteror te Punes.

Lidhur me tregun e punes dhe poltikat e punesimit, mund te themi se shifrat e papunesise jane ne masen 11,5%, duke zbritur ne masen 0,2% krahasuar me 2020. Aktualisht eshte duke u zbatuar Strategjia Kombetare per Punesim dhe Aftesim, si edhe tashme eshte duke u pergatitur draft-strategjia e re 2023-2030. Sa i takon punesimit te te rinjve, tashme eshte duke u pergatitur skema e re per punesimin e te rinjve, skeme e cila do te jete pjese integrale e Strategjise Kombetare per Punesim dhe Aftesim 2023-2030.

⁴⁶InspektoratiShteteror I Punesdhe I SherbimeveShoqerore (ISHPSHSH), Analiza e Punes-Viti 2021, Tirane 2022

⁴⁷Po aty, Analizavjetore e ISHPSHSH per vitin 2021, publikuar ne Tirane 2022

⁴⁸European Commission, Albania 2022 Report, 2022 Communication on EU Enlargement Policy, Brussels,12.10.2022

⁴⁹InspektoratiShteteror I Punesdhe I SherbimeveShoqerore (ISHPSHSH), Analiza e Punes-Viti 2021, publikuar ne Tirane 2022

⁵⁰European Commission, Albania 2021 Report, 2021 Communication on EU Enlargement Policy, Brussels,19.10.2021; European Commission, Albania 2022 Report, 2022 Communication on EU Enlargement Policy, Brussels,12.10.2022

Sipas Raport vleresimeve nga Komisioni European per Shqiperine per vitet 2021, 2022, rezulton se nga forcat aktive te punes nga mosha 15-64 vjec rezulton se pjesemarrja e grave eshte 63,2 %, nderkohe qe pjesemarrja e burrave eshte 77,7%. Kjo diference e pjesemarrjes gjinore ne tregun e punes eshte nje diference sistematike e cila duhet te permiresohet.

1.2 SIGURIA DHE SHËNDETI NË PUNË

Legjislacioni per sigurine dhe shendetin ne pune ka pesuar ndryshime te shumta, evidente qe prej vitit 2010. Shqiperia ka ratifikuar konventat e rëndesishme te Organizates Nderkombetare te Punes ne fushen e sigurise ne pune gjithashtu.⁵¹

Miratimi i Ligjit 10 237 dt 18.02.2010 ‘Per sigurine dhe shendetin ne pune’ i cili permbante parimet e rëndesishme ne fushen e sigurise dhe shendetit ne pune sikurse:

- Parimin e mbrojtjes se gjithanshme ne pune
- Parimin e trajtimit te barabarte gjinor ne fushen e sigurise dhe shendetit
- Parimin e pergjegjesise se punedhenesit
- Parimin per mbrojtjen e kategorive te vecanta, traspozonte Direktiven 89/391 te Keshillit European KEE

Ky ligj parashikon gjithashtu detyrimet e shumta ne drejtim te marrjes se masave me qellim parandalimin e demtimit te shendetit te punemarresve ne pune. Perafrimi i metejshem me direktivat e Bashkimit European ne kete drejtim pas solli miratimin e ligjeve te vecanta⁵² per mbrojtjen ne pune, si edhe nje sere aktesh nenligjore ne zbatim te tyre. Ndryshimet e kodit te punes te miratuara ne vitin 2015 perfshine gjithashtu nje sere ndryshimesh ne institutin per kushtet e punes, konkretisht lidhur me detyrimet per te garantuar vendin e punes, mjedisin e punes, perdorimin e makinerive te rrezikshme etj.

Ceshtjet lidhur me sigurine dhe shendetin ne pune i jane nenshtruar gjithashtu Strategjise Ndersektoriale “Per Sigurine dhe Shendetin ne Pune 2016-2020”.

Krahasuar me aksidentet ne pune te raportuara ne vitin 2019 me 176 raste, ne vitin 2020 keto raste u shtuan duke arritur 182, nga ku ne pjesen me tema dhe te rasteve ne sipermarrjet e prodhimit dhe ne ndertim.

Gjatë vitit 2021 rezultojnë të aksidentuar 187 punëmarrës, nga të cilët 31 punëmarrës me pasojë humbjen e jetës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë kemi rreth 14 % më pak punëmarrës të aksidentuar me vdekje por kemi dhe 2.6 % më shumë punëmarrës të aksidentuar gjithsej me të njëjtën periudhë të një viti më parë⁵³

Komisioni European vlereson miratimin e kuadrit ligjor ne fushen e sigurise dhe shendetit ne pune ne perafimin e plote me legjislacionin e Bashkimit European dhe ne perputhje me

⁵¹Konventa 155 Mbrojtja e shendetit dhe sigurise ne pune” Organizata Nderkombetare e Punes, ratifikuar me 09.02.2004; Konventa C187 “Përkuadrinpromocionaltësigurisëdhetëshëndetitnëshëndetitnëpunë”; Konventa nr. 174 “Për parandalimin e aksidenteve të rënda në industri”; Konventa nr. 176 “Sigurimi dhe shëndeti në miniera”

⁵²Ligji nr. 135, datë 22.12.2016 “Për Sigurinë dhe Shendetin në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe punimet nëntokësore në veprat hidroenergjitike”

⁵³Inspektorati Shtetëror I Punes dhe I Sherbimeve Shoqerore (ISHPSHS), Analiza e Punes-Viti 2021, publikuar ne Tirane 2022

standartet e akteve nderkombetare, por tashme kerkohet qe te forcohen kapacitetet institucionale ne perputhje me prioritetet strategjike te Bashkimit European ne drejtim te mbrojtjes se jetes dheshendetit ne pune.⁵⁴

1.3 DIALOGU SOCIAL

Dialogu social eshte nje nder mekanizmat ligjore qe synonte permiresoje legjislacionin e punes dhe zbatimin e tij gjithashtu.

Sipas raportit te Komisionit European te vitit 2022 per Shqiperine ende ka shume pune ne drejtim te forcimit te dialogut mes paleve. Sipas ketij vleresimi, progress eshte shenuar sa i takon dialogut dypalesh pergjate ratifikimit te Konventes 190 te Organizates Nderkombetare te Punes “Per dhunen dhe ngacmimin ne boten e punes”.

Keshilli Kombetar i Punes eshte mbledhur njehere pergjate vitit 2021, nderkohe qe eshte formesuar struktura perberese dhe stafi ndihmes. Dialogu social mbetet nje nder instrumentat kryesore jo vetem per te zgjidhur dhe permiresuar problematikat ne fushen e punes, por edhe nje nder mekanizmat eficente ne drejtim te perfshirjes se paleve ne procesin e negociatave per lidhjen dhe nenshkrimin e kontratave kolektive.

1.4 NDALIMI I DISKRIMINIMIT NË FUSHËN E PUNËSIMIT DHE POLITIKËS SOCIALE

Lidhur me ndalimin e diskriminimit ne punesim Shqiperia ka ndermarrenje sere reformash ligjore me qellim permiresimin e ambientit te punes per kategorite e vecanta, percaktimin e termit “ngacmim seksual” dhe percaktimin e barres se proves lidhur me te. Ne vitin 2021 Shqiperia ratifikoi Konventen 190 te Organizates Nderkombetare te Punes “Per dhunen dhe ngacmimin ne boten e punes”. Sa i takon kuadrit ligjor ekzistues, ne menyre te vecante perpos rregullimeve specifike ne Kodin e Punes, te ndryshuar, permendim Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, ofron mbrojtje në 3 fusha: fusha e punësimit, fusha e arsimit dhe fusha e të mirave dhe shërbimeve.

Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi eshte autoriteti përgjegjës, i krijuar dhe qe funksionon ne baze te Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Ky institucion siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Ankesat e trajtuara me pretendim diskriminimin në fushën e punësimit janë ankesa të depozituara kundër institucioneve publike, sikurse edhe kundër subjekteve private.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi pergjate vitit 2021 rezulton te kete trajtuar 39 ankesa vetë në këtë fushë konsiston kryesisht në problematika të shfaqura në marrëdhëniet e punës, të tilla si aksesin në punësim dhe zgjidhja e marrëdhënieve të punës. Ankesat që janë trajtuar në fushën e punësimit kanë patur si shkak të pretenduar diskriminimi: bindjet politike, gjendjen shëndetësore, gjendjen arsimore, përkatësinë në një grup të veçantë, aftësinë e kufizuar

⁵⁴European Commission, Albania 2021 Report, 2021 Communication on EU Enlargement Policy, Brussels, 19.10.2021; European Commission, Albania 2022 Report, 2022 Communication on EU Enlargement Policy, Brussels, 12.10.2022

etj. Çështjet në fushën e punësimit zënë 52% të totalit të çështjeve të trajtuara gjatë vitit 2021 me një zbritje të vogël (në përqindje) krahasuar me vitin 2020⁵⁵

1.5 BARAZIA GJINORE NË PUNËSIM DHE POLITIKA SOCIALE

Ndryshimet e Kodit të Punës, që janë në linjë me legjislacionin e Bashkimit Europian, për të mbështetur barazinë gjinore në tregun e punës, kryesisht të lidhura me rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbështetjen e fuqizimit ekonomik të grave në tregun e punës. Në këtë drejtim Komisioni Europian kërkon forcim të zbatimit të ligjit dhe monitorimit duke iu referuar nevojës së metejshme për harmonizim të legjislacionit perkates me Direktiven ‘EU work-life balance directive’.

Diferenca gjinore në Shqipëri paraqet problematika në shumë aspekte, përfshirë edhe atë të trajtimit të barabartë gjinor në punësim dhe politikën sociale. Sipas Komisionit Europian, në vlerësimin për Shqipërinë, rezultoi se për vitin 2021 rezultoi një diferencë në trajtimin gjinor (gap) prej 14,4% sa i takon punësimin dhe politikave sociale.⁵⁶

Lidhur me punësimin, sipas INSTAT, pjesëmarrja e grave në tregun e punës vazhdon të jetë 15,9% pike më e ulët se burrat për vitin 2021, ndërkohë që hendeku gjinor në pagë është 4,5% për vitin 2021.

Sipas një vlerësimi të bërë nga Banka Botërore për vitin 2020 lidhur me barazinë gjinore në Shqipëri thuhet se Shqipëria ka shënuar progress në zvogëlimin e hendekut gjinor, së përfaqësimit të grave në politikë është i lartë, por gjithësesi rezultoi se persëri grate hasin më shumë pengesa se burrat. Po kështu kërkohet përmirësimi i mëtejshëm në kuadrin ligjor, tregun e punës dhe pagat e barabarta me burrat.

Në Strategjinë e re të Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 synohet përmirësimi i kushteve të zhvillimit të biznesit dhe mbështetja për grate sipërmarrëse. Në Maj të vitit 2022 Kuvendi i Shqipërisë miratoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim, për një hua të bazuar në politikë për mbështetjen e barazisë gjinore lidhur me pjesëmarrjen në sektore të ndryshme të ekonomisë në Shqipëri”

1.6 MBROJTJA SOCIALE

Në Republikën e Shqipërisë rregullimet ligjore lidhur me mbrojtjen shoqërore behen nga Ligji i vitit 1993, i ndryshuar, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” që rregullon sistemin e sigurimeve shoqërore përfshirë sigurimin e detyrueshëm, sigurimin vullnetar, suplementar dhe pensionet e posacme. Me ligj të vecantë rregullohet sigurimi shëndetësor i detyrueshëm, perkatesisht Ligji nr 10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesitshëm shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”. Ligji i vitit 2000 rregullon statusin e personave invalide paraplegjike dhe tetraplegjike. Një sërë ligjesh të tjera dhe aktesh nenligjore rregullojnë sistemin e sigurimit shoqëror dhe shëndetësor në Shqipëri.

⁵⁵Raport Vjetor 2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

⁵⁶European Commission, Albania 2022 Report, 2022 Communication on EU Enlargement Policy, Brussels, 12.10.2022

Strategjia Sektorale e Mbrojtjes Sociale 2015 – 2020, e hartuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ka pasur qellim reformimin e Programit të Mbrojtjes Sociale nëpërmjet transformimit të Ndhmës Ekonomike në një skemë active të riintegritimit social; rishikimin e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar; ndërhyrjes dhe riintegritimit të fëmijëve në familje e komunitet duke treguar kujdes të veçantë për fëmijët jetimë social dhe biologjikë dhe ofrimin e shërbime vetë integruara. Prioritet perben sigurimi i burimeve të nevojshme për grupet më të rrezikuara nëpërmjet Fondit Kombëtar për Shërbimet Shoqërore dhe Fondeve Rajonale për Shërbimet Shoqërore si pjesë e Fondit Shoqëror.

1.7 PERFSHIRJA SOCIALE

Komisioni European ne raport vleresimin per Shqiperine per vitin 2022 vleresojne progresin e bere ne drejtim te zbatimit te Strategjise per Mbrojtjen Shoqerore, ku trajtohen ne menyre te vecante personat me aftesite kufizuara perms rritjes se perfitimeve nga sherbimet e kujdesit shoqeror. Po keshtu, raporti vlereson pergatitjen e korzinesl igjore per Urdherin e Punonjesve Sociale, rregullimet e te cilit ndihmojne ne kryerjen perpjekjeve per forcimin e kujdesit shoqeror.⁵⁷ Megjithate fondet publike ne drejtim te kryerjes se shpenzimeve per monitorimin e situates faktike dhe identifikimin e grupeve vulnerable pa akses ne sherbime te tilla pritet te jete me i larte.

Duke marre ne konsiderate shifrat e varferise te publikuara nga INSTAT ne Dhjetor 2021, te cilat mbeten ende telarta, ndryshimet qe pesoi Ligji per Ndhimen Sociale ne Dhjetor 2021 kane per qellim rritjen e ndihmes cash drejt familjeve te varfera dhe femijeve. Sipas Komisionit European pergjate vitit 2021 shperndarja e sherbimeve eshte zgjeruar ne 11 bashki te reja, duke cuar ne 16 numrin total te sherbimeve sociale te mbuluara nga Social Fund.

Pavaresisht zhvillimeve pozitive ne kete drejtim, perfshire edhe Urdherin e Bashkepunimit midis Ministrise se Shendetesise dhe Mbrojtjes Shoqerore dhe Ministrise se Ekonomise per rritjen e bashkepunimit dhe mekanizmave te perdorur ne tregun e punes, Komisioni European veren se me shume perpjekje duhen bere ne drejtim te konsolidimit te mekanizmave lidhur me Social Fund me qellim qe te garantohen parimet e:

- mjaftueshmerise,
- barazise,
- transparences dhe
- qendrueshmerise.

Po keshtu kerkohet qe te zgjerohet aksesin i personave me aftesi te kufizuar ne sherbimet publike, ne punesim, edukimin profesional dhe sherbimet e specializuara. Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021–2025, nje dokument ndërsektorial i qeverisë shqiptare përmban politika ne mbeshtetje te promovimit te integritimit te personave me aftësi të kufizuara.

⁵⁷European Commission, Albania 2021 Report, 2021 Communication on EU Enlargement Policy, Brussels,19.10.2021; European Commission, Albania 2022 Report, 2022 Communication on EU Enlargement Policy, Brussels,12.10.2022

2. REKOMANDIME

- Dialogu social tripalësh duhet të forcohet pasi luan një rol të rëndësishëm në evidentimin e problematikave dhe në zgjidhjen e tyre. Pjesëmarrja tripartite në bisedime luan një rol kyç në hartimin dhe zbatimin e politikave të duhura në tregun e punës i cili përpos problematikave lidhur me pjesëmarrjen e forcave të punës, dhe mungesës së hapjes së vendeve të reja të punës për kategoritë e vecanta, ka qenë gjithashtu në ndikimin negativ të pasojave të shkaktuara nga Covid 19, si edhe pasojat e shkaktuara nga konfliktet në arenën ndërkombëtare. Dialogu social duhet të zhvillohet si në sektorin publik, edhe në atë privat me qëllimin që gjithashtu të forcojë zbatimin e ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave në punë.
- Forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional, krijimi i urave të bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese dhe monitoruese të ligjit është i nevojshëm për të garantuar shpejtësinë në veprimtarinë kontrolluese institucionale, për të siguruar marrjen e masave të pershtatshme në rastet e konstatimit të shkeljeve dhe krijimin e mekanizmave të duhur për parandalimin e shkeljeve të legjislacionit të punës. Hartimi dhe zbatimi i planeve të veprimit dhe strategjive në këtë drejtim duhet të realizohen në mënyrë të vazhdueshme.
- Hartimi i politikave të punësimit i pershtatur me nevojat e tregut të punës, krijimi i programeve të vecanta ndërgjegjësuese për të rinjtë që janë në zgjedhje të një profesioni, si edhe hartimi i skemave dhe programeve, planeve të veprimit për të realizuar nderhyrjet e duhura në tregun e punës lidhur me punësimin e të rinjve do t'i shërbente jo vetëm uljes së shifrave të papunësisë, por do të frenonte argimin e të rinjve nga vendi.
- Reformimi i vazhdueshëm i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Sherbimeve Shoqërore. Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe infrastrukturore duhet të jetë prioritet për të garantuar përmirësimin e funksioneve monitoruese dhe kontrolluese të këtij institucioni.
- Kontratat kolektive duhet të përmirësohen sa u takon rëptimit të të drejtave kolektive lidhur me zhvillimin e negociatave për lidhjen e tyre, shtrirjen me tema dhe të tyre në sektorin privat, si edhe përmirësimi i rolit të tyre si burime të rëndësishme profesionale. Përmirësimi i dialogut social duhet të përfshihe respektimin e fazave kryesore të procesit për zhvillimin e bisedimeve me qëllim lidhjen e kontratës kolektive.
- Duhet konsideruar sistemi i zgjidhjes së konflikteve të punës. Konfliktet që burojnë nga marrëdhëniet e punës janë individuale dhe kolektive nga ku pjesa më e madhe e konflikteve individuale lidhen me zgjidhjet e kontratës së punës në mënyrë të njëanshme nga punëdhënësit (largimet nga puna), dhe ato kolektive të cilat shpeshherë u referohen largimeve kolektive nga puna ose rasteve sporadike të konfliktit midis organizatave sindikale lidhur me përfaqësueshmërinë. Përcaktimet e duhura ligjore lidhur me përfaqësimin në gjykatë për zgjidhjen e një konflikti që buron nga

marredheniet e punes, si edhe krijimi i nje sistemit e pershtatshem alternativ dhe te posacem gjithashtu per zgjidhjen e konflikteve jo vetem do i zgjidhte shpejt dhe me eficence ato, por do te permiresonte zbatueshmerine e legjislacionit te punes ne teresi.

- Duhet te rregullohen ne menyre me te detajuar pasojat e shkejes se parimit per ndalimin e punes se detyruar, perfshire edhe percaktimet e duhura ligjore lidhur me shkeljet e ketij parimi. Respektimi i ketij parimi perben prioritet ne kuader te mbrojtjes se te drejtave ne pune, si edhe levizjes se lire te punemarresve.
- Hartimi i planeve lidhur me percaktimin e objektivat e punes se denje perben nje nder ceshtjet e rendesishme jo vetem sa i takon procesit te perafritimit me standartet nderkombetare ne fushen e marredhenieve te punes, por edhe mbrojtjes e zhvillimit te vazhdueshem te te drejtave ne pune me impact te madh ne ekonomine e vendit.
- Duhet te forcohet zbatimi i ligjit dhe monitorimit duke iu referuar nevojës se metejshme per harmonizim te legjislacionit perkates me Direktiven ‘EU work-life balance directive’ perfshire eddhe ceshtjet e barazise gjinore ne punesim.
- Ashtu sikurse edhe Komisioni European sugjeron, duhet te konsolidohen mekanizmat qe I sherbejne mirefunksionimit te Social Fund me qellim qe te garantohen parime te mjaftueshmerise, barazise, transparences dhe qendrueshmerise. Duhet te realizohet mbulimi dhe shperndarja e Social Fund ne menyren e duhur.
- Duhet qe gjithashtu te zgjerohet aksesimi i personave me aftesi te kufizuar ne sherbimet publike, ne punesim, edukimin professional dhe sherbimet e specializuara.

Phone

+355 69 402 0057

Address

Rr."Frederik Shiroka" Pallati "Alba", Shk. 4, Ap. 7

Website

www.clr.al



Phone
+355 69 402 0057

Address
Rr."Frederik Shiroka" Pallati "Alba", Shk. 4, Ap. 7

Website
www.clr.al